

AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2017 - 2020



**AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
2017 - 2020**

VKM nr 372, datë 26.04.2017
“Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”

AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

2017 - 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	4
1. HYRJE	6
2. METODOLOGJIA E HARTIMIT DHE PROCESI I KONSULTIMIT	8
3. KUSHTET AKTUALE	10
3.1. MIRËQEVERISJA NË FUNKSION TË PROMOVIMIT, RESPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE	10
3.2. ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS NDAJ FËMIJËVE	11
3.3. SISTEME DHE SHËRBIME MIQËSORE NDAJ FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE ...	13
3.3.1 Zhvillimi dhe Arsimimi	13
3.3.2. Drejtësia për të miturit	15
3.3.3. Shëndeti dhe ushqyerja	16
3.3.4. Mbrojtja sociale	17
4. VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE	19
5. OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE PRODUKTET KRYESORE	21
<i>SHTYLLA STRATEGJIKE 1. Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve</i>	21
<i>SHTYLLA STRATEGJIKE 2. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve</i>	21
<i>SHTYLLA STRATEGJIKE 3. Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve</i> .	21
6. BURIMET FINANCIARE	22
7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	23
TABELA E INDIKATORËVE TË MONITORIMIT	26
MATRICA E AGJENDËS	34

Falenderime

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020 është hartuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me kontributin e Grupit Ndër-institucional të Punës ngritur me urdhërin e ministrit të MMSR, Nr. 120 datë 13.06.2016 “Për ngritjen e grupit ndër-institucional të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020” dhe drejtuar nga Zëvendës Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Znj. Bardhylka Kospiri.

Kjo Agjendë u mbështet nga UNICEF në Shqipëri, në kuadrin Programit të Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.

Kjo Agjendë u përgatit në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministritë e linjës në konsultim me përfaqësues(e) të organizatave të shoqërisë civile, si edhe të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

SHKURTESAT

AFP - Arsimi i Formimit Profesional

AKDF - Agjenda Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve

ASHDMF – Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

BE - Bashkimin Evropian

DAR/ZA – Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore

FSHS – Fakulteti i Shkencave Sociale

IAL – Institucion i Arsimit të Lartë

IEVP – Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

IGME - Grupi Ndërinstitucional për Vdekshmërinë Foshnjore (Inter – Agency Group for Child Mortality)

INSTAT – Instituti i Statistikave

ISHA – Inspektorati Shtetëror i Arsimit

ISHP – Inspektorati Shtetëror i Punës

ISHP – Instituti i Shëndetit Publik

ISHPSHSH – Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

ISHSH – Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore

IZHA – Instituti i Zhvillimit të Arsimit

KKBDF - Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

KKDMF - Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

KSHNJ - Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike

MAS – Ministria e Arsimit dhe Sportit

MÇV – Ministri për Çështjet Vendore

MD – Ministria e Drejtësisë

MMSR – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme

MSH – Ministria e Shëndetësisë

MSHIAP – Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike

NE – Ndihma Ekonomike

NJMF – Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

NJQV – Njësi të Qeverisjes Vendore

NJVNR – Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit

OBP – Organizata Botërore e Punës (ILO)

OBSH – Organizata Botërore e Shëndetit

OJF – Organizata Jofitimprurëse

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

ONZHA - Organizata Ndërkombëtare për Zhvillimin e Ligjit

OSHC - Organizatat e Shoqërisë Civile

PBB – Produkt i Brendshëm Bruto

PKIE - Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

PMF – Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve

PVF - Plani i Veprimit për Fëmijë

PVFSRr - Plani i Veprimit për fëmijët në situatë rruge 2015-2017

SHSSH – Shërbimi Social Shtetëror

SKZHI - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

SZHAPU – Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar

UNICEF – Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

ZABGJ – Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

1. HYRJE

Agjenda Kombëtare për të Drejtat Fëmijëve synon të arrijë mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar standartet ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë dhe duke nxitur një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijëve. AKDF paraqet një kuadër shumëdisiplinor dhe sistematik, i cili duhet të integrohet në të gjitha dokumentet, planet dhe veprimtaritë e tjera kombëtare dhe lokale të lidhura me fëmijët, në frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF).

AKDF udhëhiqet nga parimi kryesor i interesit më të lartë të fëmijës dhe ka si vizion krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen e sigurtë dhe të shëndetshme të fëmijëve, zhvillimin e potencialit maksimal fizik dhe psikosocial të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që prekin jetën e tyre, si dhe garantimin e vlerësimit të progresit të të drejtave të fëmijëve në fushat kryesore të politikave publike që lidhen me fëmijët.

Në planin ndërkombëtar, AKDF është hartuar në frymën e KKBDF dhe rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në Kombet e Bashkuara¹, e Strategjisë së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve 2012 - 2015² dhe 2016 - 2021³, si dhe të Agjendës së Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve⁴.

Shqipëria ka aderuar në KKBDF në 27 shkurt 1992 dhe ka ratifikuar të tre protokollat opsionale të saj. Me ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, Republika e Shqipërisë ka marrë përgjegjësinë e harmonizimit të legjislacionit dhe praktikave kombëtare me standartet e përfaqësuara nga Konventa. Zhvillimi i dokumenteve kombëtarë strategjikë është pjesë e këtij detyrimi.

Në legjislacionin kombëtar të drejtat e fëmijëve garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por edhe në një sërë ligjesh, kodesh, udhëzimesh dhe dokumentesh të tjerë ligjorë të lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Çështjet e të drejtave të fëmijëve janë në vëmendje të politikave të Bashkimit Evropian (BE) dhe zënë një vend të rëndësishëm në procesin e integritimit në BE). Në këtë kuadër, Qeveria Shqiptare ka marrë angazhime konkrete të cilat janë reflektuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI, 2015 - 2020), në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE, 2016 - 2020), si dhe në “Udhërrëfyesin për Prioritetin 5”. “Zhvillimi njerëzor dhe kohezioni social” dhe “Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës” janë shtyllat strategjike të SKZHI-së 2015 - 2020 ku bëjnë pjesë dhe të drejtat e fëmijëve. Në themel të AKDF qëndrojnë dokumente strategjike dhe plane veprimi kombëtare, të cilat përcaktojnë drejtimit kryesor të veprimit të Qeverisë në këto fusha dukë përfshirë edhe prioritetet që kanë ndikim në jetën e fëmijëve. Këto dokumente janë:

- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014 - 2020;
- Strategjia e Mbrojtjes Sociale, 2015 - 2020;
- Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale, 2016 - 2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016 - 2020;

1. United Nation Committee on the Rights of the Child (2012). Concluding observations the combined second to fourth periodic reports of Albania, adopted by the Committee at its sixty-first session. E marrë nga http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fALB%2fCO%2f2-4&Lang=en e aksesuar në Gusht 2016. Versioni në shqip në faqen e Agjencisë: <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Rekomandimet-e-Komitetit-p%C3%ABr-t%C3%AB-Drejtat-e-F%C3%ABmij%C3%ABS-Gjenev%C3%AB.pdf>

2. Këshilli i Evropës, Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2012 - 2015. Marrë nga <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/cdcj/StrategyCME.pdf> e aksesuar në 18 qershor 2016

3. Këshilli i Evropës, Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2016 - 2021. E marrë nga <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168066cff8> e aksesuar në 17 qershor 2016.

4. Bashkimi Evropian, Agjenda e BE – së për të Drejtat e Fëmijës, 2011. E marrë nga http://ec.europa.eu/justice/policies/children/docs/com_2011_60_en.pdf e aksesuar në 15 qershor 2016.

- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, 2015 - 2020;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014 - 2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016 - 2020;
- Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, 2017 - 2021;
- Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit, 2014 - 2017;
- Strategjia Ndërsektoriale, Axhenda Dixhitale e Shqipërisë, 2015 - 2020;
- Strategjia e Strehimit Social, 2016 - 2025

AKDF konsolidon dhe krijon vazhdimësi me Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015. Mësimet e marra nga zbatimi i PVF-së dhe rekomandimet e nxjerra janë marrë plotësisht parasysht në vlerësimin e nevojave për ndërhyrje si pjesë e kësaj agjende.

AKDF përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh prioritetet e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe njëkohësisht, një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit të Qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët relevantë.

Kjo agjendë përmban tre shtylla strategjike (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve; (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve; dhe (iii) Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve: zhvillimi dhe arsimimi, drejtësia, shëndeti dhe ushqyerja dhe mbrojtja sociale.

- AKDF synon përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve duke synuar përforcimin e kuadrit rregullator dhe insitucional, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendim-marrje.
- Angazhimi për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve konfirmohet si një prioritet i rëndësishëm i qeverisë, nëpërmjet një qasjeje të integruar sistemike. AKDF synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një kuadri ligjor dhe insitucional të përmirësuar ndjeshëm. Objektivat dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve janë hartuar në përputhje me Dokumentin e politikave “E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri”⁵.
- Në pjesën e tretë AKDF synon nxitjen e proceseve dhe sistemeve miqësore me fëmijët, si në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore, dhe drejtësi. Në këtë aspekt është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Qasja e përdorur si bosht për agjendën është ajo e të drejtave të fëmijëve. Kjo qasje e konsideron çdo fëmijë një qenie njerëzore unike dhe njëlloj të vlefshme, mendimi i të cilit/ës duhet të dëgjohet në të gjitha situatat vendimmarrëse për të, përfshirë këtu dhe proceset gjyqësore, që ka të drejtë jo vetëm për të jetuar dhe mbijetuar por për zhvillim deri në arritjen e potencialit të vet maksimal, që ka të drejtë për pasjen e jetës më të mirë të mundshme.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë agjendë kanë kryesisht natyrë ndërsektoriale për të adresuar nevojat për parandalim, mbrojtje, ndërhyrje afatgjata, ofrimin e shërbimeve miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve dhe promovimin e të drejtave duke adresuar normat sociale. Natyra e objektivave dhe e

5. <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2016/06/E-ARDHMJA-E-SISTEMIT-T%C3%8B-INTEGRUAR-P%C3%8BR-MBROJTJEN-E-F%C3%8BMIJ%C3%8BS-N%C3%8B-SHQIP%C3%8BRI.pdf>

ndërhyrjeve është njëkohësisht holistike, duke synuar një impakt më të madh në jetën e fëmijëve.

Financimi për zbatimin e AKDF është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministritë përkatëse të linjës. Në disa raste, buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, kështu që AKDF përfshin një evidentim të hendeikut të financimit si dhe propozimin për fonde nga partnerët dhe donatorët. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për realizimin e aktiviteteve të përfshira në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në këtë agjendë, e cila fokusohet kryesisht në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore. Për të adresuar nevojën e kanalizimit të burimeve financiare dhe njerëzore në nivel vendor drejt garantimit të të drejtave të fëmijëve, vetë AKDF parashikon hartimin e planeve vendore për të mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilët të kthejnë në angazhime konkrete në nivel vendor prioritetet dhe vizionin e AKDF.

Zbatimi i AKDF do të monitorohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me asistencën e Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për procesin e mbledhjes së të dhënave, në kuadrin e monitorimit dhe raportimit të progresit.

Një kontribut të rëndësishëm në hartimin e AKDF ka dhënë UNICEF në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes me asistencë teknike për procesin e draftimit programatik dhe të konsultimit me aktorë të ndryshëm. Konsultimi me ministritë e linjës, me aktorët në nivel vendor, me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) si dhe me vetë fëmijët ka ushqyer dhe shoqëruar procesin e hartimit të kësaj agjende.

2. METODOLOGJIA E HARTIMIT DHE PROCESI I KONSULTIMIT

AKDF është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me kontributin e *Grupit Ndërinstitucional të Punës* ngritur me Urdhërin e Ministrit të MMSR, Nr. 120 datë 13.06.2016 “Për ngritjen e grupit ndër-institucional të punës për hartimin e AKDF. Grupi institucional ka në përbërjen e tij përfaqësues nga:

- 1) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,
- 2) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës,
- 3) Shërbimi Social Shtetëror,
- 4) Ministria e Arsimit dhe Sportit,
- 5) Ministria e Shëndetësisë,
- 6) Ministria e Punëve të Brendshme,
- 7) Ministria e Drejtësisë,
- 8) Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore,
- 9) Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë Turizmit dhe Sipërmarrjes,
- 10) Ministria e Financave,
- 11) Ministria e Zhvillimit Urban,
- 12) Ministria e Integritimit Evropian,
- 13) Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike,
- 14) INSTAT.

Ky grup bashkërendoi punën edhe me aktorë të tjerë për hartimin e draftit final të AKDF. Puna e grupit institucional të punës u asistua nga një sekretariat teknik i përbërë nga specialistë të MMSR dhe ASHDMF-së. Me mbështetjen e UNICEF në Shqipëri, një grup ekspertësh u përfshinë në draftimin e dokumentit (korrik - nëntor 2016), dhe konsultimin me aktorë të fushave të ndryshme.

AKDF është hartuar përmes një procesi konsultimi ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, organizatat e shoqërisë civile, kryesisht ato që kanë në fokusin e tyre fëmijët, si dhe komuniteti ndërkombëtar. Metodologjia e përdorur për hartimin e agjendës ka patur në qendër pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve që në hapat e parë të hartimit të saj. Për këtë arsye janë realizuar një sërë takimesh konsultuese me aktorët dhe grupet e interesit si dhe rishikim sistematik i të dhënave, në mënyrë që të sigurohet përfaqësues dhe ndërhyrjet e bazura në evidenca.

Për të realizuar hartimin e agjendës me pjesëmarrjen e aktorëve janë përdorur këto metoda:

- *Analiza e dokumenteve*, përfshirë këtu strategjitë ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare, dokumente zyrtarë dhe raporte, të dhëna statistikore, ligje/politika me qëllim sintetizimin e informacionit për aktivitetet e shkuara, sigurimin e shembujve të praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra dhe mirë - pozicionimin e agjendës me strategjinë tërësore të Qeverisë.
- *Takime/seminare në grupe të mëdha*, me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë shtetërorë, në nivel qendror dhe vendor, si dhe të shoqërisë civile. Rezultatet e nxjerra nga seminarët kanë shërbyer si bazë për grupin e hartimit të Agjendës. Janë realizuar dy seminare të tilla në nivel qendror, i pari në fillimin e procesit për të përcaktuar prioritetet strategjike (në datën 21 qershor 2016) dhe i dyti në fazën e kur agjenda ishte draftuar për të marrë komentet e të gjithë aktorëve (në 26 shtator 2016). Gjithashtu, janë organizuar 2 takime të tjera me përfaqësues të nivel vendor (në datën 28 shtator 2016 në Tiranë me përfaqësues nga NJQV e Tiranës dhe Durrësit dhe në datën 30 shtator 2016 në Shkodër me përfaqësues nga NJQV Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë).
- *Takime/seminare në grupe të vogla* me ministritë e linjës, me përfaqësues nga pushteti vendor, me OSHC dhe me organizata ndërkombëtare;
- *Fokus grupe me fëmijët*. AKDF është dokumenti i parë politik, i cili është konsultuar me grupe fëmijësh mbështetur në parimin dhe të drejtën e tyre themelore, pjesëmarrjen e fëmijëve. Konsultimi i agjendës u realizua më mbështetjen e organizatës World Vision në formën e 5 fokus grupeve, të organizuara sipas metodologjisë *World Café*, ku fëmijët shprehën pikëpamjet e tyre në lidhje me secilën prej fushave tematike që përmban AKDF. Rekomandimet e dala nga fokus grupet janë përmbledhur në një raport dhe janë marrë në konsideratë nga grupi hartues i agjendës. Në vijim, përfaqësues të grupeve të fëmijëve u takuan në Tiranë me Ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, ku ndanë rekomandimet e tyre lidhur me Agjendën. Fëmijët vinin nga Lezha, Korça, Durrësi, Shkodra, Kurbini, Mamurrasi, Laçi, Miloti, Elbasani dhe Tirana⁶.

Matrica e Agjendës përshkruan shtyllën strategjike, objektivat, indikatorin/ët e rezultatit, fushën e veprimit dhe veprimtaritë përkatëse, indikatorët e produktit, koston e vlerësuar të produktit, afatet e zbatimit, autoritetet përgjegjëse për zbatimin duke përcaktuar një institucion udhëheqës, dokumentet strategjike sektoriale përkatës me të cilët Agjenda ka objektiva/veprimtari të përbashkëta, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Agjendës.

Aktivitetet e Agjendës janë të bazuara në nevojat e fëmijëve të identifikuar nëpërmjet analizës së dokumenteve dhe konsultimit me aktorët. Nga ana tjetër, ato janë prioritetizuar sipas kapaciteteve dhe burimeve aktuale të qeverisë për t’iu përgjigjur këtyre aktiviteteve.

6. Pjesëmarrja e fëmijëve u mundësua nga organizata World Vision dhe një pjesë e fëmijëve nga Tirana u mundësuan nga organizata Save the Children.

Fazat e përgatitjes së AKDF ishin:

- *Faza përgatitore*, gjatë së cilës është hartuar një draft i shtyllave strategjike të AKDF. Më pas janë marrë sugjerimet e të gjitha ministrave të linjës dhe Departamentit të Strategjive në Këshillin e Ministrave, të cilat janë reflektuar.

- *Faza e hartimit*, gjatë së cilës janë zhvilluar pjesa më e madhe e konsultimeve mes anëtarëve të grupit të punës së bashku me grupin e ekspertëve dhe përfaqësues të ministrave të linjës, pushtetit vendor, OSHC dhe organizatave ndërkombëtare dhe me fëmijët, për të diskutuar dhe përcaktuar objektivat dhe aktivitetet në secilën shtyllë strategjike.

Gjatë kësaj faze janë organizuar gjithashtu një seri takimesh prezantuese të drafteve të ndërmjetme, të koordinuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, Ministrinë e Integritimit Europian, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike.

- *Faza e prezantimit publik*, gjatë së cilës AKDF është paraqitur në publik dhe është diskutuar dhe marrë mendimi gjerësisht. Kjo fazë shënon dhe përfundimin e hartimit të agjendës.

3. KUSHTET AKTUALE

Ky seksion bazohet në raportin e vlerësimit të Planit të Veprimit për Fëmijë që kishte kohështrirje në periudhën 2012 - 2015 si dhe në analizën e dokumenteve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

3.1. MIRËQEVERISJA NË FUNKSION TË PROMOVIMIT, RESPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Ligji aktual (Datë 4.11.2010) “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” ishte një hap i madh përpara në momentin kur u miratua, pasi më në fund u futën në legjislacionin vendas të drejtat e fëmijëve dhe u hodhën bazat e një sistemi për mbrojtjen e fëmijëve. Ndërkohë, implementimi i këtij ligji ka paraqitur shumë problematika. Raporte të deritanishme mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri⁷ kanë evidentuar problematika të këtij ligji lidhur me fushën e të drejtave, si p.sh.: pamjaftueshmëria e përcaktimeve ligjore për të realizuar implementimin praktik në kontekstin e vendit; mungesa e roleve të qarta/mirëpërcaktuara të aktorëve të ndryshëm në fushën e të drejtave të fëmijëve, duke i dalluar ato nga fusha e mbrojtjes së fëmijëve. Për më tepër, harmonizimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve me legjislacionin në vend nuk ka qenë sistematik, duke shënuar ndryshime ligjore sporadike në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve.

Strukturat qendrore dhe lokale përgjegjëse sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve (2010), siç përcaktohen më poshtë kanë hasur një sërë sfidash për të realizuar funksionet e tyre në këtë fushë⁸. Kapacitetet (financiare dhe njerëzore) në nivel kombëtar (Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës) kanë qenë të kufizuara për të përmbushur me efektivitet të gjithë detyrimet e përcaktuara në ligj.

7. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve & UNICEF (2014) “Raporti Kombëtar mbi Situatën e të drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2013-2014”;

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve & Save the Children (2016) “Raporti i Implementimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015”; Të marra nga <http://femijet.gov.al/al/raporte-2>, aksesuar më 16 Nëntor 2016.

8. UNICEF (2015) “Raporti për Fëmijë/Child Notice”; Marrë nga https://www.unicef.org/albania/resources_25504.html, aksesuar më 30 nëntor 2016.

Në kuadër të miratimit të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, del si domosdoshmëri vlerësimi/identifikimi dhe plotësimi i nevojave për zhvillim të kapaciteteve në të gjithë nivelet e qeverisjes në përputhje me përcaktimet ligjore për fushën e të drejtave, me qëllim përmbushjen sa më efektive të funksioneve dhe mbi të gjitha përparimit/realizimit të të drejtave të fëmijëve në vend. Draftimi i kësaj agjende është zhvilluar dhe harmonizuar me procesin e hartimit të këtij ligji. Duke u bazuar në përvojën e zbatimit të ligjit të mëparshëm, aprovimi i ligjit të ri ka nevojë të ndiqet me miratimin e të gjithë akteve nënligjore dhe harmonizimin e tij me ligje të tjera. Për më tepër, lind nevoja për vlerësim të impaktit për fëmijët të të gjithë legjislacionit të ri që do të hartohet, me qëllim integrimin e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijëve në vend.

Monitorimi dhe raportimi i realizimit të të drejtave të fëmijëve është penguar nga mungesa e disponueshmërisë së të dhënave sistematike, të besueshme me fokus fëmijët, dhe veçanërisht ata në situata vulnerabiliteti⁹.

Në dy dekadat e fundit, Shqipëria është bazuar kryesisht në të dhënat statistikore të anketimeve për të ofruar një panoramë mbi situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve. Por, këto ndërmarrje janë mbështetur nga fonde të institucioneve ndërkombëtare, duke krijuar një boshllëk në sigurimin e të dhënave sistematike/të vazhdueshme në fushë. Nga ana tjetër, ndryshimet e sistemeve sektoriale të manaxhimit të informacionit nuk kanë realizuar integrimin e treguesve me fokus fëmijët, apo aspekte të vulnerabilitetit të tyre. Problematike mbetet situata e kapaciteteve në nivel lokal për të mbledhur, analizuar dhe raportuar të dhënat për fëmijët. Bashkuar këto me mungesën e një kulture institucionale për vendim-marrje/politikë-bërje bazuar në evidence, krijohet një rreth vicioz pengues i monitorimit dhe raportimit efektiv të situatës së të drejtave të fëmijëve¹⁰.

Institucionet e të drejtave të njeriut, si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kanë në fokus dhe të drejtat e fëmijëve. Me ndryshimet e bëra në ligjin 8454, dt 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar tashmë është përmbushur një nga rekomandimet që Komiteti i të Drejtave të Njeriut, në Kombet e Bashkuara ka lënë për Shqipërinë. Është parashikuar ligjërisht krijimi i një Seksioni të vecantë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Megjithatë ende nuk është përcaktuar Komisioneri për të drejtat e fëmijëve pranë këtij institucioni.

3.2. ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS NDAJ FËMIJËVE

Dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve ndikon në zhvillimin e tyre emocional dhe social, por edhe në realizimin e të drejtave të tjera¹¹. Përveç impaktit të dhunës në viktimat e saj, studimet kanë treguar se dhuna shkakton dhe kosto ekonomike për shoqërinë¹². Evidencat tregojnë se barra ekonomike e trajtimit të dhunës ndaj fëmijëve është më e madhe se ajo e programeve efektive parandaluese¹³.

Të dhënat mbi prevalencën e dhunës dhe format e dhunës tek fëmijët janë sporadike. Sipas raportit të fundit organizatës World Vision mbi mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri (2016) 3 në 4 fëmijë të varfër në Shqipëri pohojnë se e kanë ndeshur dhunën dhe abuzimin në jetën e tyre, por më pak se 15% janë gati për t’ia treguar këtë dikujt. Dhuna psikologjike është forma e dhunës që raportohet më së shpeshti nga fëmijët¹⁴. Rreth 61,69% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës psikologjike një herë në jetën e tyre; 48,42% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës fizike gjatë jetës së tyre, dhe 59,45% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike gjatë vitit të kaluar. 11.4% e fëmijëve kanë përjetuar ngacmim

9. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve & UNICEF (2014) “Raporti Kombëtar mbi Situatën e të drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2013-2014”;

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve & Save the Children (2016) “Raporti i Implementimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015”; Të marra nga <http://femijet.gov.al/al/raporte-2>, aksesuar më 16 Nëntor 2016.

10

11. Këshilli i Evropës (2016). Strategjia e të Drejtave të Fëmijëve 2016 - 2021.

12. Child Fund Alliance (2014). The costs and economic impact of violence against children. E marrë nga <http://childfundalliance.org/ep-content/uploads/2014/10/ODI-Policy-Brief.-The-cost-and-economic-impact-of-violence-against-children.pdf> e aksesuar në 13 qershor 2016.

13. Fang, X., Brown, D. S., Florence, C. S. dhe Mercy, J. A. (2012). The economic burden of child maltreatment in United States and implications for prevention. Child Abuse and Neglect, 36 (2): fq. 156 - 165. <http://dx.doi.org/10.1016/j.chiabu.2011.10.006>

14. Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B. (2013), Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Studimi Epidemiologjik në Ballkan mbi Abuzimin e Fëmijëve dhe Neglizhencën (BECAN), CRCA Shqipëri, Tiranë.

seksual dhe 4.88% e fëmijëve dhunë seksuale me kontakt, të paktën një herë gjatë jetës së tyre¹⁵.

Të dhëna nga shqetësimet e fëmijëve që kontaktojnë shërbimit telefonik ALO 116 111 tregojnë se arsytet më të shpeshta të telefonatave janë: probleme me bashkëmoshatarët, prindërit dhe mësuesit, probleme me bullizmin, me abuzimin fizik, seksual dhe emocional dhe me dhunën në familje¹⁶. Ndërkohë, në raportin e të dhënave vjetore të punës së NJMF-ve tregohet se nga 555 raste në ndjekje gjatë vitit 2015, 63% janë raste neglizhimi, 19% raste të abuzimit psikologjik, 13% raste të abuzimit fizik dhe 5% të abuzimit seksual (Shih Grafikonin 1.).



Grafiku 1. Numri i rasteve në ndjekje sipas llojit të abuzimit

Abuzimi seksual është një nga format më ekstreme e dhunës ndaj fëmijëve, dhe sipas studimeve ai ndodh më shumë në rrethin e besimit. Fëmijët prirën të mos e raportojnë dhe profesionistët po ashtu për shkak të pasigurisë¹⁷. Ende në Shqipëri mungon shërbimi i trajtimit të specializuar dhe afatgjatë për fëmijët viktime të abuzimit seksual dhe/ose të formave të rënda të dhunës.

Gjithashtu, forma të tjera të dhunës janë të pranishme në mjedise të ndryshme ku fëmijët duhet të ndihen të sigurtë. Një prej tyre, bullizmi është një fenomen shqetësues në shkollat 9 - vjeçare dhe të mesme¹⁸.

Puna e detyruar e fëmijëve dhe trafikimi i tyre vazhdojnë të ekzistojnë si fenomene. Trafikimi ndërkombëtar i fëmijëve për në vendet fqinje, sidomos drejt Kosovës, ka qenë në rritje¹⁹. Plani i Veprimit për Fëmijët në Situatë Rruge 2015 - 2017 po zbatohet në 7 Bashki dhe ka patur rezultate pozitive në shumicën prej tyre. Në raportin e vitit 2015 - 2016 janë menaxhuar 345 raste të fëmijëve në situatë rruge.

Sa i përket përdorimit të internetit dhe ngacmimeve në mjedisin digjital studime tregojnë se fëmijët shqiptarë qëndrojnë shumë gjatë në internet, përballen me ngacmime (cyberbullying) dhe me ekspozime në materiale/informacione të papërshtatshme me moshën (p.sh. 44% e të pyeturve kanë raportuar se shohin përditë në internet material pornografike, qoftë dhe rastësisht duke lundruar)²⁰.

Fëmijët në lëvizje shpesh përballen me vulnerabilitete specifike dhe janë më të ekspozuar ndaj dhunës. Shpeshherë duhet të përballen me ndarjen, vështirësi psikologjike dhe traumë, dhe me abuzimin fizik, emocional dhe seksual. Sipas të dhënave të mbledhura në kufirin jugor nga gushti deri në nëntor 2016, 43 % e personave të arrestuar ishin fëmijë dhe 33% prej tyre ishin nën moshën 11 - vjeçare.

Megjithëse vihet re një rritje e ndërgjegjësimit të publikut ndaj rasteve të dhunës që prekin fëmijët, numri i raportimeve është i ulët. Në veçanti vihet re një numër i vogël raportimesh nga fëmijët të cilët punojnë me fëmijët²¹.

Plani i Veprimit për Fëmijët 2012 - 2015 i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit²². Sipas raportit të vlerësimit të këtij plani rreth 70% e masave të

15. ASHDMF (2014). Raport Kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013 – 2014. E marrë nga <http://eurokonventa.al/wp-content/uploads/2015/01/Raport-komb%C3%ABtar-mbi-situat%C3%ABn-e-te-drejtave-t%C3%AB-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf> e aksesuar në 13 qershor 2016

16. UN Children's Fund (UNICEF), Child Notice Albania, 23 July 2015, e marrë nga <http://www.refworld.org/docid/55b0dda14.html> e aksesuar në 13 Qershor 2016

17. Burazeri, G., Qirjako, G. dhe Tahsini, I. (2015). Abuzimi seksual në rrethin e besimit në Shqipëri. *Terres des Hommes*

18. Ismaili, E. (2015). Bullizmi në shkollat 9 - vjeçare të Tiranës. Doktoraturë.

19. Strategjia kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 - 2017

20. World Vision në Shqipëri dhe Kosovë (2016). Siguria e fëmijëve online: fletë faktesh. E marrë nga <http://www.wvi.org/sites/default/files/10-02-2015-Flet%C3%AB-Faktesh-WV-v2-b.pdf> e aksesuar në 3 shtator 2016.

21

22 ASHDMF (2012). Plani kombëtar i veprimit për fëmijë 2012 - 2015.

parashikuara për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi janë arritur²³.

Mbrojtja e fëmijëve, edhe pse ka qenë e pranishme si një shqetësim për më shumë se një dekadë, nuk është strukturuar si një sistem, dhe nuk është trajtuar të paktën si një fushë programore multisektoriale. Modeli aktual i sistemit, edhe pse përmban elemente të ndryshëm, është ende i fragmentuar dhe i bazuar te problemi.

Përfshirja e profesionistëve të fushave të ndryshme në kuadrin rregullator nuk është shoqëruar deri më tani, me hartimin e instrumentave specifikë të profesionistëve të ndryshëm. Studimet e ndryshme kanë konstatuar mangësi në kapacitetet e profesionistëve në të gjitha fazat e menaxhimit të rastit. Nga ana tjetër, monitorimi i pamjaftueshëm i morisë dhe shpeshësisë së rasteve rezulton në një mungesë informimi për të formësuar modelin e programit dhe për të planifikuar shërbimet dhe ndërhyrjet. Kjo rezulton në elemente parandalues që nuk e trajtojnë zanafillën e shkaqeve të episodeve të mbrojtjes së fëmijëve²⁴. Të dhënat për mbrojtjen e fëmijëve duhen dixhitalizuar dhe vendosur në një sistem unik për mbledhjen e tyre.

Në shkurt 2017 u miratua ligji Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i cili zëvendëson legjislacionin e mëparshëm dhe propozon parashikimet për ngritjen e sistemit në nivel qendror dhe vendor. Hartimi i ligjit është sinkronizuar me hartimin e AKDF, duke siguruar kështu planifikimin e masave të domosdoshme pasuese të aprovimit të ligjit.

3.3. SISTEME DHE SHËRBIME MIQËSORE NDAJ FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

3.3.1 Zhvillimi dhe Arsimimi

Aktualisht, shteti shqiptar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit ka një Strategji për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar (SZHAPU)²⁵, e cila përcakton qëllimet strategjike deri në vitin 2020. Në vlerësimin e Planit për Fëmijë 2012 - 2015 rezulton se 60% e masave të parashikuara janë përmbyshur.

Në fushën e shërbimeve të kujdesit në fëmijërinë e hershme dhe arsimin parashkollor ka patur investime gjatë viteve të fundit, kryesisht në infrastrukturë. Megjithatë, aksesin në çerdhe është i kufizuar, veçanërisht në zonat rurale²⁶. Numri i saktë i çerdheve dhe i fëmijëve që frekuentojnë në to është i panjohur, edhe pse ASHDMF ka kërkuar të dhëna nga pushteti vendor gjatë dy viteve të fundit²⁷. Për herë të parë ofrohen të dhëna për 46 fëmijë Romë të regjistruar në 9 çerdhe në 2014²⁸. Nga të dhënat të raportuara nga 61 bashkitë rezulton se për vitin 2016, numri total i çerdheve është 93, ndërsa numri i bashkive pa çerdhe është 20²⁹.

Disa nga sfidat kryesore lidhen me mungesën e standardeve të përkujdesjes, mirërritjes dhe zhvillimit në fëmijërinë e hershme dhe të instrumenteve të inspektimit dhe monitorimit të tyre si dhe mungesën e programeve për prindërimin e mirë në komunitet³⁰.

Vitet e fundit janë ndërmarrë reforma madhore dhe shumë të larmishme për arsimin, të cilat përfshijnë: reformën e kurrikulës, përmirësimin e trajnimit të mësuesve, një shpërndarje më të barabartë të burimeve përgjatë qarqeve, përmirësimin e kushteve të të nxënësve, një rritje të pagave mesatare të mësuesve, dhe një

23. ASHDMF (2015). Raporti i Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijë 2012 - 2015.

24. ibid

25. MAS (2015) “Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar” E marrë nga <http://www.arsimi.gov.al/arsimi/shkolla/strategjia-e-zhvillimit-te-arsimit-parauniversitar-2014-2020>, e aksesuar në 15 qershor 2016.

26. Rodríguez, A. M. (2013) “Impakti i shërbimeve të kujdesit dhe zhvillimit të fëmijërisë së hershme mbi fuqizimin e grave në Shqipëri”, UNICEF Shqipëri.

27. Raport Kombëtar mbi Situatën e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (2014). UNICEF Shqipëri. E marrë nga <http://eurokonventa.al/wp-content/uploads/2015/01/Raport-komb%C3%ABtar-mbi-situat%C3%ABn-e-te-drejtave-t%C3%AB-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf> e aksesuar në 4 shtator 2016

28. ASHDMF (2014). Raporti kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

29. sipas VKM 267

30. Haxhiymeri, E., Ndri, M., Hallkaj, E., Boci, A. (2014) “Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, rezidencial dhe çerdheve për të mbështetur zhvillimin në fëmijërinë e hershme në Shqipëri” Unicef në Shqipëri

ristrukturim i përmbajtjes dhe administrimit të provimeve të maturës³¹. Gjithsesi, buxheti i alokuar për këtë sektor mbetet nga më të ultit në rajon 4% PBB³².

Niveli neto i regjistrimit në institucionet e arsimit parashkollor arriti 81.3 % në vitin 2014, duke shënuar progres në krahasim me shifrat e regjistrimit 50% në vitin 2004. Regjistrimet në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta janë pothuajse universale (përkatësisht 99.4% dhe 95.66%), dhe midis viteve 2009 dhe 2014, regjistrimet bruto në arsimin parashkollor u rritën nga 65.66 në 88.56%. Përafërsisht 92% e nxënësve mbarojnë arsimin bazë dhe vazhdojnë studimet në nivelin e mesëm³³. Edhe pse përqindjet e raportuara janë të larta, sërish ato bazohen vetëm në braktisjen e fëmijëve që janë regjistruar në sistemin shkollor, nuk ka të dhëna për fëmijët që nuk kanë qenë asnjëherë të regjistruar.

Të dhënat e mbledhura nga MAS hedhin dritë mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar që ndjekin shkollën, por gjithëpërfshirja e tyre has në shumë sfida në praktikë, disa prej të cilave të lidhura me buxhetimin e përshtatshëm sipas nevojave të tyre, dhe të tjera të lidhura me krijimin e një mjedisi miqësor dhe gjithëpërfshirës brenda në shkollë.

37 % e njerëzve të njohur si refugjatë në Shqipëri janë fëmijë dhe të gjithë frekuentojnë arsimin publik. Ata janë ndihmuar me kurse të gjuhës shqipe nëpërmjet partnerëve të UNHCR – së. Në përfundim të arsimit të mesëm, ata marrin një kod regjistrimi dhe kanë të drejtën të vazhdojnë studimet universitare, sikurse ka ndodhur për disa prej tyre gjatë viteve të mëparshme. Për momentin nuk ka akte nënligjore që t'i rregullojnë kriteret për ofrimin e ndihmës dhe nivelin e shpenzimeve dhe ky hendek plotësohet me ndihmën e organizatave jo – fitimprurëse.

Përqindjet e braktisjes së shkollës synuan të ishin drejt zeros (përqindja e braktisjes së shkollës në arsimin bazë në vitin 2009 ishte 0.46%, ndërsa në vitin 2012 ishte 0.39%). Në vitin 2014 numri i fëmijëve jashtë arsimit bazë ishte 7097 (4.07%), më i ulët se vitet e mëparshme³⁴. Braktisja e shkollës është më shqetësuese për vajzat rome dhe për djemtë dhe vajzat e familjeve me të ardhura të ulëta, ose familjeve që përballen me probleme të ndryshme sociale³⁵. Tendanca e fëmijëve Egjiptianë për të ndjekur shkollën është pak më e lartë se e fëmijëve Romë, me 3.4% të braktisjes. Rreth 34.4% e fëmijëve romë të moshës 7-18 vjeç kanë mbetur analfabetë përdërisa ata nuk e kanë ndjekur shkollën; vitet mesatare të shkollimit të fëmijëve romë janë përafërsisht 5.5%³⁶.

Nga ana tjetër, edhe pse raportohet se përqindja e të rinjve që dinë të shkruajnë dhe të lexojnë është 99%³⁷, rezultatet e provimit ndërkombëtar të PISA të vitit 2012 vlerësuan se performanca e nxënësve shqiptarë ishte poshtë mesatares së standardeve të OECD-së. Rezultatet e PISA 2015 treguan rritje të nivelit të të nxënësve, por mbetet sërish vend për përmirësim. Gjithashtu, që prej dy vjetësh ka filluar implementimi i Kornizës së Re Kurrikulare, e cila ka në qendër nxënësin dhe bazohet mbi kompetencat³⁸.

Mësuesit e arsimit parashkollor dhe parauniversitar prej disa vitesh kanë qenë pjesë e një sistemi për edukimin e vazhdueshëm, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka hartuar Udhëzimin Nr 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. Ky sistem synon të zhvillojë kapacitetet trajnuese dhe të rrisë efektivitetin e formave të zhvillimit profesional të mësuesve, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

31. Banka Botërore (2015). ALBANIA World Bank Group Partnership Program Snapshot April 2015. Marrë nga <https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania-Snapshot.pdf> i aksesueshëm në qershor 2016

32. Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014 - 2020

33. UNESCO (2015). Përqindja neto e regjistrimit të Shqipëri sipas nivelit të arsimit. Marrë nga <http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?queryid=127> i aksesueshëm në janar 2016.

34. UNESCO (2015). Raporti i fëmijëve jashtë sistemit shkollor, arsimit bazë. E marrë nga http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?DataSetCode=EDULIT_DS e aksesuar në 4 shtator 2016

35. Cuninghame, C. dhe Hallkaj, E. (2015). Children's rights situation analysis. Save the children

36. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Zyra e Statistikave

37. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Zyra e Statistikave (2015).

38. IZHA (2014). Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar.

Sa i përket funksionimit të strukturave demokratike në shkolla raportohet se në vitin 2013 pothuajse në të gjitha shkollat e inspektuara nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), janë ngritur organet kolegjiale si: Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Pedagogjik, Qeveria e Nxënësve dhe Këshilli i Disiplinës. Megjithatë, funksionimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë e vazhdueshme.

Njëkohësisht nisma e shkollës komunitare po realizohet në 250 shkolla. Kjo nismë përfaqëson tashmë një strukturë dhe mundësi konkrete për përfshirjen e komunitetit në jetën e shkollës, si edhe mbështetjen dhe pasurimin e vazhdueshëm të përvojave jetësore të fëmijëve/nxënësve.

3.3.2. Drejtësia për të miturit

Sipas Raportit “Implementimi i Planit Kombëtar për Fëmijët 2012 - 2015”, në fushën e drejtësisë për të mitur, rezultoni se janë zbatuar vetëm përafërsisht 35% e masave të parashikuara³⁹.

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ende ka një përfaqje ndëshkuese ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Në një masë të madhe nuk arrin të marrë parasysh nevojat e tyre për mbrojtje, në respekt të të drejtave të tyre njerëzore dhe dinjitetit megjithëse ka patur disa përmirësime gjatë viteve të fundit. Që në vitin 2009, me prezantimin e Shërbimit të Provës, jepen dënime alternative deri në 58% të rasteve të të miturve. Numri i fëmijëve që kanë kaluar nga paraburgimi gjatë viteve të mëparshme përgjithësisht ka qenë i paqëndrueshëm. Megjithatë, në vitin 2015 (208 raste) ka patur një rënie të dukshme (rreth 40%) në krahasim me vitin 2014 (338 raste). Ditët e qëndrimit aty kanë pësuar rënie vetëm në vitin 2015 me një mesatare prej 125 ditësh (krahasuar me 140 në 2014)⁴⁰.

Gjithashtu, jo rrallë procesi i drejtësisë për të miturit nuk është i përshtatshëm dhe miqësor për fëmijët. Janë bërë përpjekje për të ngritur kapacitetet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë, megjithatë kanë qenë sporadike. Gjithashtu, me qëllim promovimin e dhënies së dënimeve alternative për të miturit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, është e nevojshme të hartohen programe integrimi në komunitet, të forcohen më tej zyrat e shërbimit të provës përmes ngritjes/përmirësimit të kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës. Realizimi i programeve integruese dhe riintegruese të qëndrueshme ka si qëllim uljen e nivelit të recidivizmit për fëmijët e përfshirë në sistemin e paraburgimit⁴¹. Për të gjitha arsyt e lartpërmendura, lind nevoja e përmirësimit të përmbajtjes dhe procedurave të administrimit të drejtësisë për fëmijë.

Ligji për të Huajt 108/2013, neni 21, parashikon burgimin si zgjidhjen e fundit për fëmijët me shtetësi të huaj që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Shqipërisë. Megjithatë, në vitin 2016 një numër fëmijësh janë mbajtur në paraburgim së bashku me familjet e tyre duke pritur rikthimin e tyre për në Greqi.

Për sa i përket aksesit në drejtësi, sipas studimit të realizuar nga zyra rajonale e UNICEF – it dhe IDLO, 95% e fëmijëve shqiptarë të pyetur dhe familjet e tyre janë shprehur se i njohin të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, ndërkohë që kishin shumë më pak njohuri për forumet gjyqësore, mekanizmat apo rrugët që mund të përdornin për të kërkuar të drejtat. Fëmijët shqiptarë kishin mësuar për këto kryesisht nga shkolla dhe mediat⁴². Për këtë arsye, edukimi ligjor i fëmijëve që në fazat e para të jetës, ndër të tjera duke përmirësuar kurrikulat për arsimimin të tyre është një domosdoshmëri. Po aty theksohet se fëmijët përballen me një sërë barrierash për të aksesuar materialisht sistemin e drejtësisë. Në Shqipëri, më shumë se në vendet e tjera të studimit, fëmijët përballen me pengesa si: mungesa e legjitimitetit të pavarur, kufizime financiare, distanca fizike nga gjykatat/institucionet, mungesa e informacionit dhe e mbështetjes, mungesa e besimit ndaj institucioneve, pranimit kulturor i dhunës në familje, perceptimi për vendin e fëmijëve në familje etj.

39. Raporti i Implementimit të Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2012 – 2015.

40. DPB (2015). Të dhëna statistikore. E marrë nga <http://www.dpbsh.gov.al/neëëeb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=72> e aksesuar në 5 shtator 2016

41. ASHMDF (2015). Raporti Kombëtar mbi Situatën e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2013 - 2014. E marrë nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2015/03/Raport-komb%C3%ABtar-mbi-situat%C3%ABn-e-te-drejtave-t%C3%AB-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf> e aksesuar në 25 qershor 2016.

42. UNICEF CEE/CIS dhe IDLO (2015). Aksesi i barabartë i fëmijëve në drejtësi: studim rajonal në Shqipëri, Gjeorgji, Mali i Zi dhe Kyrgyzstan. E marrë nga http://www.unicef.org/ceecis/Equitable_aces_to_justice_for_children_in_Central_and_Eastern_Europe_and_Central_Asia_-_v2_1.pdf e aksesuar në 15 qershor 2016

3.3.3. Shëndeti dhe ushqyerja

Shërbimet e përshtatshme të kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe adoleshentët duhet të përfshijnë një qasje të integruar, që synojnë garantimin e aksesit të plotë bazuar në parimet e disponueshmërisë, të qenit të hapur, barazisë dhe shumëdisiplinaritetit, dhe mbi të gjitha të arritjes së potencialit maksimal të zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve. Në vlerësimin e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012 - 2015 rezultoi se 70% e masave në fushën e të drejtës së kujdesit shëndetësor janë përmbushur.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijët në Shqipëri ofrohen falas nëpërmjet shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Kujdesit Spitalor. Në zonat urbane për fëmijët pas moshës 6 vjeç kujdesi parandalues ofrohet nga mjeku i shkollës dhe/ose mjeku i përgjithshëm/mjeku i familjes përgjegjës për kujdesin e fëmijës⁴³.

Në vitet e fundit janë miratuar një seri udhëzuesish dhe protokolle për kujdesin e gruas shtatzënë, foshnjeve dhe fëmijëve, përfshirë ushqyerjen. Gjithsesi, UNICEF thekson se ndërsa shërbimet shëndetësore për nënën dhe fëmijën janë të mirë-themeluar, ato nuk janë në përputhje me këto standarde⁴⁴. Ofrimi i shërbimeve të kufizuara, infrastruktura fizike jo gjithmonë e përshtatshme, kapacitetet e pamjaftueshme të ofruesve të shërbimeve, mungesa e llogaridhënies dhe barrierat financiare që përballojnë grupet e popullatës kufizojnë dhe më shumë aksesin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Veçanërisht fëmijët vulnerabël hasin dhe në më tepër vështirësi⁴⁵.

Treguesit mbi shëndetin e fëmijëve nuk mblidhen dhe raportohen në mënyrë të rregullt. Të dhënat më të fundit të lidhura me statusin e shëndetit të fëmijëve janë nga Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri (SDSS) 2008-2009. Një tjetër burim të dhënash vjen nga Grupi Ndërinstitucional për Vdekshmërinë Foshnjore (ang. *Inter - Agency Group for Child Mortality, IGME*), që raportoi për vitin 2015 se vdekshmëria foshnjore dhe e fëmijëve nën 5 vjeç është respektivisht 13 dhe 14 për 1,000 lindje të gjalla, krahasuar me afërsisht 30 të tilla në fillim të viteve 2000⁴⁶. Pavarësisht uljes së dukshme të vlerave të treguesve, mbetet sërisht punë për të sjellë rezultate të krahasueshme edhe me vendet e tjera.

Vaksinimi i fëmijëve mbetet i lartë ndër vite, duke përfshirë aktualisht deri në 98% të popullatës fëmijë. Por duhet patur parasysh se përqindja e përjashtuar është e vështira për t'u arrirë, dhe me tepër gjasa t'i përkasë grupeve më vulnerable.

Fëmijët nga komuniteti Rom dhe/ose Egjiptian kanë tregues shëndetësor më të ulët se sa të pjesës tjetër të popullsisë. Shkaqet duhen kërkuar tek varfëria, kushtet e vështira të jetesës, mundësia e kufizuar për të përdorur shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, niveli i ulët arsimor e mungesa e infrastrukturës. Një vlerësim i fundit me fokus fëmijët Romë 0-6 vjeç evidenton se largësia nga Qendrat Shëndetësore është një faktor që vështirëson aksesin. 14,4% e qendrave janë mbi 2 km distancë nga vendbanimet Rome. 61.7% e fëmijëve kanë marrë vaksinat sipas kalendarit, për rreth 17% të fëmijëve stafi shëndetësor nuk ka informacion mbi statusin e vaksinimit të fëmijëve. Në rreth 68.8% të rasteve fëmijët gëzojnë shëndet të mirë, por kjo nuk qëndron për 5.4% të tyre⁴⁷.

Sipas SDSS, shumica e fëmijëve nën 5 vjeç janë ushqyer me gji (95%) të paktën një herë, por vetëm 35% e foshnjave 0-5 muajshe ushqehen ekskluzivisht me gji. Një përqindje e vogël e fëmijëve (6-23 muajsh) ushqehen sipas praktikave të ushqyerjes së foshnjeve dhe fëmijëve⁴⁸. Iniciativa "Spitale - mike të foshnjës" ka disa vite që implementohen në Shqipëri, por mbetet për t'u bërë akoma një vlerësim i efektshmërisë së saj,

43. *Terres des homes* (2016). Analiza e situatës për parandalimin e keqtrajtimin të fëmijëve në Shqipëri. E marrë nga http://www.euro.who.int/__data/assets/pdf_file/0017/307520/Situation-analysis-prevention-child-maltreatment-Albania-al.pdf?ua=1 e aksesuar në 15 qershor 2016.

44. Haxhiymeri, E., Ndrio, M., Hallkaj, E., Boci, A. (2014) "Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, rezidencial dhe cerdheve për të mbështetur zhvillimin në fëmijërinë e hershme në Shqipëri" Unicef në Shqipëri

45. ASHMD (2015). Raporti Kombëtar mbi Situatën e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2013 - 2014.

46. Child Mortality Estimates (2015). Albania country data. E marrë nga http://www.childmortality.org/index.php?r=site/graph#ID=ALB_Albania e aksesuar në 17 qershor 2016.

47. Hazizaj A., Elezi P., Ballo M. (2014). "Vlerësim Kombëtar mbi aksesin e fëmijëve romë në shërbimet e edukimit dhe shëndetësisë në Shqipëri." UNICEF në Shqipëri E marrë nga <http://www.sidalbania.org/romacom.html> e aksesuar në 6 qershor 2016.

48. INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik (2010). Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-2009.

e më pas përmirësimi dhe shtrirja e tij në të gjitha institucionet shëndetësore.

Prevalenca e mbipeshës (21.6%) tek fëmijët shqiptarë të moshës 7-10 vjeç në bazë të vlerave kufi të OBSH-së është shumë afër mesatares evropiane të grup-moshës 6-10 vjeç (24%) (35) duke e theksuar mbipeshën dhe obezitetin e moshës feminare si një problem të rëndësishëm për shëndetin e fëmijëve⁴⁹. Dy pasoja të kequshqyerjes janë ende të konsiderueshme në Shqipëri: prapambetja në rritje (19%) është ulur, por ende përbën problem në, kurse mbipeshës (22%) te fëmijët është tendencë në rritje⁵⁰. Veç arsyeve të tjera, një faktor kontribues në këto shifra shqetësuese është mungesa e rregullave dhe e zbatimit të tyre për marketimit ose tregtimin e produkteve ushqimore në institucionet arsimore publike dhe jopublike.

AKDF parashikon një fuqizim të iniciativave për mirë-ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve si dhe monitorim të zbatimit të strategjive dhe legjislacionit kombëtar që rregullon aktivitetet e lidhura me mirë-ushqyerjen. Këto do të kryhen në një përfaqje gjithë-përfshirëse dhe multisektoriale, duke bërë analiza të situatës dhe fuqizim të kapaciteteve sipas nevojave.

Sipas SDSS, shtatëzanitë në moshë të re 15-19 vjeç arrijnë 12% në moshën 19 - vjeçare por në moshën 15 - vjeçare janë thuajse të papërfillshme nëse jo inekzistente, por këto të dhëna i referohen vetëm vitit 2010⁵¹.

Të rinjtë kanë nevojë për shërbime të tjera nga ato të të rriturve, kështu që duhet të vihet fokusi më shumë në informim, mbështetje psikosociale, promovim dhe masa parandaluese⁵². Këto nevoja kërkojnë një përshtatje në organizimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe një përfaqje tjetër nga profesionistët e shëndetësisë si dhe nga profesionistët të tjerë të pranishëm në këtë sektor (punonjësit e shëndetësisë, punonjësit socialë, psikologët). Stafi që punon me të rinjtë duhet të jetë i kualifikuar për adoleshencën dhe zhvillimin në këtë moshë, si dhe të shfaq aftësi ndërpersonale dhe ndjeshmëri ndaj diversitetit.

Aktivitetet që parashikohen në këtë agjendë janë në përputhje me parimet e strategjive të tjera sektoriale. Si të tilla, aktivitetet e lidhura me shëndetin në këtë agjendë duhen parë dhe kuptuar në harmoni me ato të planifikuara nga Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, dokumentet strategjike të Shëndetit Riprodhues, Promocionit Shëndetësor, Shëndetit Mendor etj., të fokusuar për fëmijët dhe sidomos për ata në nevojë, me qëllim zbutjen e pabarazive dhe garantimin e të drejtave për një jetë dhe shëndet më të mirë të mundshëm. Këto aktivitete i shërbejnë arritjes së qëllimeve në rang kombëtar duke forcuar bashkëpunimin ndër-sektorial, por nuk synojnë të shpjegojnë arritjen e objektivave vetëm me zbatimin e aktiviteteve të përfshira në këtë agjendë.

3.2.4. Mbrojtja sociale

Në vlerësimin e Planin e Veprimit për Fëmijë 2012 - 2015 rezultoi se janë përmbushur 70% e masave në fushën e përfshirjes sociale.

Sipas Anketës së Matjeve të Standardeve të Jetesës niveli i varfërisë si shprehje direkte e përjashtimit social ka shënuar rritje në 14.3% në vitin 2012, në krahasim me shifrën 12.5% në vitin 2008⁵³. Gjithsesi, në krahasim me shifrat e varfërisë për popullsinë në përgjithësi, ato të lidhura me fëmijët janë më të lartë - 20.1% për vitin 2012⁵⁴. Në zonat rurale kjo përqindje është më e madhe me 21.4%, ndërsa në zonat urbane 18.9%. Familjet me më shumë se 4 fëmijë, kanë përqindjen më të lartë të varfërisë në vend, rreth 49.6%, ndërsa fëmijët e grupmoshës 0-4 vjeç, zënë përqindjen më të lartë të fëmijëve, që jetojnë në varfëri absolute, 22%⁵⁵. Studime

49. Instituti i Shëndetit Publik (2013). Vlerësimi i obezitetit në moshën feminare. E marrë nga http://www.ishp.gov.al/multimedia/Vleresimi_%20i_%20Obezitetit_%20ne_%20moshen_feminore_V2.pdf e aksesuar në 14 qershor 2016.

50. Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, 2017 - 2021

51. INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik. Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2018-2009.

52. OBSH (2005). Strategjia Evropiane për Shëndetin e Fëmijëve dhe të Adolehentëve.

53. SKZHI II 2015 - 2020

54. Të dhënat për jetesën dhe mbijetesën në Shqipëri 2012

55. Shqipëria: Trendi i Varfërisë", botim i INSTAT, shtator 2013

të ndryshme kanë lidhur varfërinë e fëmijëve me dimensione të shtuara të deprivimit të tyre⁵⁶. Fenomeni i varfërisë është kthyer në një fenomen sa rural edhe urban, për shkak të trendeve të lëvizjes së popullsisë. Megjithatë, ende në Shqipëri nuk ka të dhëna të sakta dhe të disagreguara, të cilat të tregojnë nivelin dhe thellësinë e varfërisë tek fëmijët në mënyrë që edhe ndërhyrjet për zbutjen e saj të jenë më efektive.

Në mbështetje të grupeve më të varfra, struktura e përgjithshme e mbrojtjes sociale në sistemin e mirëqënies sociale në Shqipëri konsiston në dy paketa të mëdha: atë të transfertave direkte në para kesh (*ang. cash*) dhe atë të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Sipas të dhënave administrative për vitin 2014, 132.000 fëmijë të varfër janë në përbërje të familjeve përfituese të NE⁵⁷. Numri më i madh i familjeve me fëmijë që përfitojnë nga skema ekonomike janë në zonat veriore si Kukës dhe Dibër, dhe më pak në Durrës dhe Tiranë. Sistemi i ri i Ndhmës Ekonomike, pilotuar në Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ka synuar targetimin e familjevë më të varfëra. Për herë të parë, kjo skemë, prezanton pagesa 'të kushtëzuara' për ndjekjen e shkollës dhe vaksinimin e fëmijëve të familjeve përfituese. Pagesa përfituese ekzistuese mund të lehtësojë në zbutjen e varfërisë, por nuk arrin të mbrojë në mënyrë të duhur fëmijët dhe familjet nga varfëria dhe deprivimi.

Rreth 17,698 fëmijë me aftësi të kufizuara, marrin shërbimet dhe pagesat e nevojshme të përcaktuara nga legjislacioni. Nga këta, rreth 9345 fëmijë janë të regjistruar në sistemin arsimor. Ligji i ri për aftësinë e kufizuar, i miratuar në 2014, krijon kushtet e nevojshme për respektimin e barabartë të të drejtave të të gjithë grupimeve të personave me aftësi të kufizuara, duke përafëruar legjislacionin shqiptar me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁵⁸. Reformimi i sistemit të mbështetjes për këtë kategori pritet t'i prezantojë një targetim të ri, në përputhje me standardet ndërkombëtare, por në nevojë për burimet e domosdoshme dhe të specializuara. Aktualisht, niveli i investimit për mbrojtjen sociale është ndër më të ulët në rajon - 1.6% të PBB. Ky investim shkon kryesisht për NE në kesh, me investime minimale në mbështetjen sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror.

Bashkitë, në kuadër të objektivave strategjike të reformës administrative – territoriale⁵⁹, të miratuar në Korrik të vitit 2014, kanë rolin kryesor në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët në nivel vendor⁶⁰. Neni 24 i Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton përgjegjësitë e NJQV në fushën e shërbimeve sociale. Ato lidhen kryesisht me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, me ofrimin e disa lehtësive financiare për grupet vulnerable (p.sh. ulja e çmimit në disa shërbime si transporti publik), por edhe me administrimin e qendrave sociale ose me hapjen e qendrave të reja dhe me ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë kryefamiljare, viktimat e trafikimit etj⁶¹. Në këtë kuadër roli i NJQV - ve është fuqizuar, por mekanizmat e funksionimit dhe të financimit akoma nuk janë konsoliduar. Ngritja e shërbimeve të emergjencës, shërbimit të kujdestarisë së përkohshme, shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara, për fëmijët në situatë rruge në nivel vendor është një nevojë imediate për këto kategori fëmijësh. Shërbimet e kujdesit shoqëror të ofruara në nivel vendor janë shumë të pakta dhe ineficente⁶². Studime të fundit sugjerojnë se ka një nevojë të dukshme për më shumë shërbime të kujdesit shoqëror në të gjitha bashkitë, veçanërisht në ato ku shkalla e vulnerabilitetit është e lartë dhe kanë më shumë popullatë vulnerable⁶³. Për këtë arsye, mund të thuhet se ende ka shumë nevoja të paplotësuara.

Krahas kategorive të fëmijëve në nevojë të përmendur më sipër, nuk duhet harruar nevoja për t'i ofruar

56. Observatori për të drejtat e fëmijëve (2013). Varfëria e fëmijëve në Shqipëri, Kartë raportuese nr. 1. UNICEF në Shqipëri. E marrë nga <http://www.unicef.org/albania/ChildPovertyInAlbania-A113.pdf> e aksesuar në 5 qershor 2016.

57. Shërbimi Social Shtetëror (2014). Të dhëna administrative.

58. ASHMDF (2015). Raporti Kombëtar mbi Situatën e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2013 – 2014. E marrë nga <http://eurokonventa.al/ep-content/uploads/2015/01/Raport-komb%C3%ABtar-mbi-situat%C3%ABn-e-te-drejtave-t%C3%AB-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf> e aksesuar në 30 gusht 2016

59. Miratuar me ligjin nr. 115/2014, datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

60. Duci, V. (2016). Perceptimi i qytetarëve mbi ofrimin e shërbimeve në Bashkinë Shkodër. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

61. Neni 24 i Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

62. UNICEF (2015). Child notice. Albania

63. Miluka, J. et al. (2015). Supporting planning of social care services, vulnerability mapping. Instituti i Studimeve Bashkëkohore dhe UNICEF në Shqipëri. E marrë nga http://www.unicef.org/albania/Supporting_Planning_of_Social_Care_Services-Vulnerability_Mapping.pdf e aksesuar në 15 qershor 2016.

shërbime dhe për të respektuar të drejtat e fëmijëve që jetojnë me HIV/AIDS. Ata nuk vuajnë vetëm nga një problem shëndetësor, por edhe nga stigmatizimi social. Këta fëmijë përballen me një realitet të vështirë, ku shumë prej të drejtave të tyre mund të shkelen për këtë arsye nevoja është imediate për të adresuar nevojat e tyre me shërbime.

Në kuadër të deinstitutionalizimit, raporti vjetor i Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2015 tregon se numri i fëmijëve të vendosur në qendra të përkujdesit social u ul me 46.7% krahasuar me vitin 2014; ka patur 87 rikthime në familje dhe 44 birësime, që përbëjnë 15% të fëmijëve që trajtohen në institucione të përkujdesit shoqëror rezidenciale për fëmijë⁶⁴. Shërbimet institucionale rezidenciale formojnë një pjesë të rëndësishme të shërbimeve të kujdesit social. Bazuar në një studim të fundit, më shumë se 37%, (320), e totalit të fëmijëve të vendosur në institucione rezidenciale ishin nën moshën 3 vjeç në kohën kur u pranuan. Modeli i pranimit të fëmijëve të vegjël në institucionet, që kalojnë më pas në kujdesin institucional afatgjatë, duket relativisht i qëndrueshëm. Përqindja e fëmijëve të regjistruar si të pranuar në institucion për arsye të varfërisë së familjes ishte pothuajse dy herë më shumë se sa i atyre të regjistruar si të 'braktisur'⁶⁵. Gjatë viteve të fundit, është mbështetur financiarisht ngritja dhe funksionimi i modeleve "shtëpi familje". Gjithsesi, në kuadër të deinstitutionalizimit, raporti progresit vjetor për Komisionin Evropian (2015) vë në dukje se duhet më shumë punë për të rikthyer fëmijët në kushtet e familjes, për të zgjeruar kujdesin alternativ dhe për të siguruar mbrojtje të veçantë për fëmijët në institucione rezidenciale⁶⁶. Programet e fuqizimit të familjeve biologjike janë në fazat e parë. Gjithsesi, është i nevojshëm planifikimi i të gjithë përpjekjeve në këtë fushë në një kuadër plani veprimi, me masa veprimi të mirë-përcaktuara, të buxhetuara, dhe tregues të matshëm e të realizueshëm.

4. VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Agjenda Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve synon të arrijë mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar standartet ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë dhe duke nxitur një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijëve.

AKDFA 2017 - 2020 udhëhiqet nga *parimet* e të drejtave të fëmijëve:

- **Interesi më i lartë të fëmijës** duhet të prevalojë në çdo veprim apo ndërhyrje që lidhet me fëmijët;
- **Mos-diskriminimi**: Të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të drejtat e tyre pa diskriminim të asnjë lloji.
- **E drejta e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim** duhet të garantohet në maximumin e mundësive.
- **Pikëpamja dhe mendimi i fëmijës** duhet të merret parasysh në të gjitha çështjet që e prekin atë në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij.

Vizioni i AKDF është krijimi i një mjedisi të favorshëm për rritjen e sigurtë dhe të shëndetëshme të fëmijëve, zhvillimin e potencialit maksimal fizik dhe psikosocial të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që prekin jetën e tyre, si dhe garantimin e vlerësimit të progresit të të drejtave të fëmijëve në fushat kryesore të politikave publike që lidhen me fëmijët.

AKDF ka një natyrë të dyfishtë. Nga njëra anë ajo përfaqëson një dokument strategjik, që shpreh prioritetet e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve për katërvjeçarin 2017-2020, duke përcaktuar prioritetet dhe fusha veprimi te reja dhe të paparashikuara nga strategjitë sektoriale lidhur me mirëqeverisjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, dhe përmirësimin e programeve ekzistuese në fushat e zhvillimit dhe arsimit, drejtësisë, shëndetësisë dhe ushqyerjes dhe mbrojtjes sociale.

64. Shërbimi Social Shtetëror (2016). Raport 2015. E marrë nga <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2016/05/Raporti-Shssh-2015.pdf> e aksesuar në 25 qershor 2016.

65. UNICEF (2014). A survey of children resident in public and non – public institutions in Albania. P. Evans and Future Center. E marrë nga http://www.unicef.org/albania/sq/2014-Albania_stock_floer_analysis_report_ver3.pdf e aksesuar në 15 qershor 2016

66. Raport - progresi për integrimin në BE. Albania

Njëkohësisht, ky dokument krijon një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit të Qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët, duke reflektuar prioritetet lidhur me fëmijët të strategjive publike, si dhe përcaktimin e treguesve që do të mundësojnë matjen e progresit.

AKDF është orientuar për të patur ndikim dhe rezultate të prekshme në jetën e fëmijëve nëpërmjet treguesve të matshëm. Në themel të një pjese të mirë të AKDF qëndrojnë strategjitë dhe planet e veprimit të hollësishme të përgatitura nga institucionet përgjegjëse përkatëse.

Shtyllat strategjike të AKDF janë:

- i. **Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duke mundësuar** përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit e situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive, si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendim-marrje.
- ii. **Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve**, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional të përmirësuar ndjeshëm, si dhe adresimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve siç është bullizmi, dhuna në shkollë, disipinimi pozitiv, dhuna në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik dhe fëmijët në situatë ruge, siguria e fëmijëve në mjedisin digjital, fëmijët e pashoqëruar ose viktimë të trafikimit, etj. Një fokus të rëndësishëm ze parandalimi si një strategji kyçe për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, duke i dhënë fokus të veçantë programeve që synojnë nxitjen e një prindërimi pozitiv pa dhunë.
- iii. **Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve**, nxitjen e proceseve dhe sistemeve miqësore me fëmijët, si në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore, dhe drejtësi. Në këtë aspekt është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Në secilën prej shtyllave strategjike janë përfshirë disa **komponentë të tërthortë**:

- Promovimi, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në situata vulnerabiliteti, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët e varfër, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët në lëvizje, etj.
- Pjesëmarrja e fëmijëve në të gjitha fushat dhe proceset që prekin jetën e tyre, që kërkon që fëmijët dhe familjet të jenë plotësisht të informuar për çështjet që i interesojnë.
- Promovimi i ndërhyrjeve të bazuara në evidenca, si dhe gjenerimi i evidencave në fushat përkatëse, përfshirë procesin e monitorimit dhe vlerësimit.
- Nxitja e ndërhyrjeve parandaluese sistematike dhe efektive në të gjitha fushat e veprimtarisë.

Këta komponentë kanë shërbyer edhe si kritere për krijimin e kornizës monitoruese të strategjive të tjera sektoriale në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

Për realizimin e qëllimeve strategjike të agjendës është e nevojshme të bëhen ndryshime në kuadrin ligjor, të plotësohet infrastruktura për realizimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha nivelet e shoqërisë, të ngrihen ose të riorganizohen struktura në nivel qendror dhe vendor, të bëhet alokimi i mjaftueshëm i buxheteve për fëmijët si dhe të koordinohet ofrimi i shërbimeve mes nivelit qendror dhe vendor. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile ka gjithashtu rëndësi themelore në kuadrin e proceseve të reformave për realizimin e të drejtave të fëmijëve, për ndërgjegjësimin për të drejtat e fëmijëve, për ofrimin e ekspertizës por edhe për mbështetjen në ofrimin e shërbimeve cilësore miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.

5. OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE PRODUKTET KRYESORE

Ky dokument përmban 3 objektiva strategjikë dhe 14 objektiva specifikë. Në të njëjtën kohë, objektivat janë shoqëruar me indikatorët përkatës (sasiorë dhe cilësorë) si dhe me kostot e detajuara për çdo aktivitet. Për një vlerësim të përafërt të kostove të nevojshme për zbatimin e PKVR së, janë marrë në konsideratë programet buxhetore afat-mesme të ministrive të linjës të përfshira në këtë plan për periudhën 2015-2017. Gjithashtu janë përllogaritur në mënyrë të përafërt të gjitha aktivitetet e tjera të cilat përmbushin objektivat e këtij plani edhe pse nuk kanë burime financiare në buxhetin e PBA-ve të ministrive të linjës, por janë kategorizuar në fonde të pambuluara, të cilat mund të mbulohen nga donatorë në të ardhmen. Për këtë qëllim parashikohet të zhvillohen konsultime direkte me agjencitë financuese në Shqipëri, me qëllim drejtimin e kontributit të donatorëve për disa nga aktivitetet e këtij plani.

SHTYLLA STRATEGJIKE 1. Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Objektivi strategjik 1. Përmirësimi i funksionimit të mekanizmave për të drejtat e fëmijëve

Objektivi 2: Avancimi i të drejtave të fëmijëve si pjesë e AKMDF

SHTYLLA STRATEGJIKE 2. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve

Objektivi 3: Përmirësimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për një sistem të integruar dhe efektiv të mbrojtjes së fëmijëve

Objektivi 4: Përmirësimi i aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve

SHTYLLA STRATEGJIKE 3. Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve **Fusha e zhvillimit dhe arsimit**

Objektivi 5: Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç)

Objektivi 6: Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit në arsim për fëmijët në arsimin bazë

Objektivi 7: Përmirësimi i mekanizmave për mjedise gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar

Objektivi 8: Përmirësimi i proceseve demokratike në shkollë

Fusha e drejtësisë

Objektivi 9: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në drejtësi

Fusha e shëndetësisë dhe ushqyerjes

Objektivi 10: Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor për foshnjat dhe fëmijët

Objektivi 11: Krijimi i mjedisit mbështetës për ofrimin e praktikave optimale të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve

Objektivi 12: Përmirësimi i sistemit shëndetësor dhe shërbimeve që ofrohen për adoleshentët, duke i bërë ato miqësore

Fusha e mbrojtjes sociale

Objektivi 13: Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për të ofruar mbrojtje dhe përkujdes shoqëror më të mirë ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë

Objektivi 14: Fuqizimi i familjes për të adresuar rreziqet dhe pasojat e varfërisë dhe parandaluar ndarjen e fëmijës nga familja

6. BURIMET FINANCIARE

Kostoja e totale e përlogaritur për zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit është rreth **2 miliardë e 363 milionë e 099 mijë lekë**. Burimet e përcaktuara për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në programet 10460 “Përfshirja sociale”; 10430 “Përkujdesi social”; si edhe programi 10110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” mbulojnë rreth 9% të kostos së përlogaritur për këtë Axiendë ose rreth 0,1% të totalit të buxhetit /PBA për vitin 2017 të kësaj Ministrie. Burimet financiare nga donatorët mbulojnë rreth 11% të kostos së strategjisë. Hendeku financiar i pambuluar në buxhet është 221,497,000 leke dhe është pjesë e bisedimeve me donatorë.

Kostimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë është realizuar bazuar në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke i konsideruar shpenzimet e projekteve të trupëzuara në produkte. Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor afatmesëm në Republikën e Shqipërisë siç parashikohet në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave.

Kostimi dhe buxheti i planit të veprimit të kësaj strategjie është mbështetur në elementet e mëposhtëm:

Kostot për zbatimin e strategjisë konsiderojnë jo vetëm shpenzimet kapitale si: investime në infrastrukturë (kryesisht IT), por edhe ato korente si: trajnimet, fushatat promovuese, inspektime, realizimi i sondazheve, përgatitja dhe publikimi i raporteve të ndryshme, të cilat janë konsideruar për garantimin e kapaciteteve të nevojshme për implementimin e strategjisë.

Kostot e parashikuara për tu financuar nga donatorët janë konsideruar si shpenzime kapitale do të përdoren për kualifikime, fushata promovionale etj në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave.

Fushat e strategjisë	Qeveria Shqiptare	Donatore	Boshllëku financiar	Total
1. Eliminimi i dhunes	157,152,500	21,350,000	110,300,000	288,802,500
2. Shërbime miqësore për fëmijet:	1,299,387,369	556,555,000	111,197,000	1,967,139,369
a. Zhvillimi arsimi	278,971,869	199,000,000	37,500	478,009,369
b. Drejtësia	809,015,500	68,610,000	-	877,625,500
c. Shëndetësia	93,002,500	222,630,000	94,080,000	409,712,500
d. Mbrojtja sociale	118,397,500	66,315,000	17,079,500	201,792,000
3. Qeverisja për të drejtat e fëmijëve	65,257,500	41,900,000	-	107,157,500
TOTAL STRATEGJIA	1,521,797,369	619,805,000	221,497,000	2,363,099,369

7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Shumica e aktiviteteve të parashikuara në AKMDF për të arritur objektivat strategjikë kërkojnë bashkëpunim dhe bashkërendim të punës së aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu njësitë e qeverisjes vendore, por edhe shoqërinë civile.

Parashikohet se do të ketë një vlerësim afatmesëm dhe një vlerësim përfundimtar, të kryesuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si organi koordinues dhe të lehtësuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Agjenda përcakton edhe formatin që do të përdoret për monitorimin dhe vlerësimin (M&V) e këtij dokumenti me qëllim arritjen në kohë dhe cilësi të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në këtë plan. Agjenda është dokumenti bazë mbi të cilin ngrihet mekanizmi i M&V, ku do të përfshihen indikatorë cilësorë dhe sasiorë.

Kuadri vlerësues dhe monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e resurseve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me Urdhërin e Kryeministrit Nr.129 datë 21.09.2015 “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) të cilat monitorojnë reformat sektoriale në Shqipëri në përputhje me Prioritetet e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij Plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve në takimet e Nën Grupit Tematik të Përfshirjes Sociale që do të udhëhiqet nga MMSR dhe përberje të strukturave ndërsektoriale.

Në mënyrë që të rritet llogaridhënia në çdo aktivitetet është parashikuar të paktën një institucion përgjegjës për zbatimin e aktivitetit përkatës sikundër dhe institucionet përgjegjëse për monitorimin. Agjenda është ndërsektoriale, në të cilën janë përfshirë shumë aktorë dhe institucione të ndryshme të cilët në shumicën e aktiviteteve të parashikuara në këtë plan do të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve. Prandaj, për një monitorim dhe vlerësim cilësor të këtij plani, është i domosdoshëm një bashkëpunim dhe mirëkoordinim midis aktorëve si në shkëmbimin e informacionit ashtu dhe në procesin e zbatimit të këtij plani. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të kalojë përmes disa fazave si : Mbledhja e të dhënave; Analizimi i të dhënave; Raportimi dhe llogaridhënia.

Mbledhja e të dhënave dhe e informacionit të nevojshëm për matjen e indikatorëve të përcaktuar është një etapë thelbësore e procesit të monitorimit. Ky informacion do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Agjendës si dhe në të njëjtën kohë do të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij plani.

Bazuar në detyrimin ligjor, zbatimi i Planit të Veprimit monitorohet gjithashtu nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. MMSR do të ketë rolin kryesor në monitorimin, koordinimin dhe menaxhimin e Agjendës nëpërmjet Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, e cila mbledh, analizon dhe raporton të dhënat lidhur me realizimin e Agjendës dhe raporton të paktën një herë në vit tek Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Monitorimi do të kryhet edhe në mënyrë indirekte përmes vizitave në terren, mbledhjes së të dhënave nga partnerët dhe raportimet përkatëse.

Ministritë e linjës si dhe agjencitë e tjera (shtetërore apo të huaja) që janë pjesë përbërëse e kësaj agjende, janë përgjegjëse për arritjen e objektivave përkatëse (nën mandatin e tyre) të parashikuara në Agjendë.

Qëllimi i vlerësimit të dokumentit është të verifikojë sesa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë arritur

në mënyrë të sukseshme objektivat strategjike dhe specifike të planit dhe mbi të gjitha a ka patur ndonjë ndikim në nivel lokal dhe kombëtar.

Vlerësimi do të bëhet në fund të çdo viti dhe do të bazohet në raportet e mbledhura për realizimin e indikatorëve të përcaktuar në çdo objektiv ku do të vlerësohet cilësia e realizimit të aktiviteteve, efektet përkatëse, ndryshimet ligjore apo institucionale, e të tjera.

MMSR/ASHDMF do të jetë përgjegjëse direkte për koordinimin dhe sigurimin e cilësisë së mbledhjes së të dhënave ndërsa institucionet partnere do të jenë përgjegjëse për raportimin e të dhënave sipas planeve përkatëse. Raporti vjetor i vlerësimit, do të paraqitet tek Nën Grupi Tematik i Përfshirjes Sociale, Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i cili do të sigurojë përshtatjen e masave për arritjen e objektivave strategjike, duke marrë parasysh risqet që duhet të menaxhohen në vazhdimësi, si dhe pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhen dy vlerësime me rëndësi strategjike pasi do të influencojnë drejtpërdrejt në ri-organizimin dhe ri-formulimin e objektivave specifike dhe aktiviteteve:

- *Një vlerësim afatmesëm*, që do të zhvillohet në fund të vitit 2018, do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Bazuar në këtë vlerësim, mund të rishikohen aktivitetet e planit të veprimit për të arritur objektivat e vendosura në strategji dhe buxheti për vitet në vazhdim.
- *Një vlerësim përfundimtar*, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë Agjendën dhe ndikimin e saj të përgjithshëm. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve të ndryshme.

Për të patur një format të plotë raportimi i cili do të bëjë të mundur paraqitjen cilësore të arritjeve të Agjendës, do të hartohet formati përkatës i raportimit. ASHDMF do të jetë përgjegjëse për hartimin e raporteve të ndërmjetme (3-mujore) dhe atij vjetor. Raporti vjetor do të ndahet me grupin ndërmnistror dhe pas komenteve përkatëse do të dërgohet pranë Ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe KKDFM. Në të njëjtën kohë, raportet vjetore do të jenë të hapura për shoqërinë civile dhe publikun të cilët do të japin komentet dhe opinionet e tyre në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të Agjendës.

Tabela e Indikatorëve të Monitorimit

Fusha e veprimit	Përshkrimi i treguesve	Baseline	Synimi afatmesëm	Synimi afatgjatë
Mirëqeverisja në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve	Udhëzuesi i miratuar lidhur me pjesëmarrjen e fëmijëve në nivel ndërkombëtar, qendror dhe vendor, bazuar në indikatorët e Këshillit të Evropës rreth pjesëmarrjes së fëmijëve.	Për vitin 2015 numri i dëgjësave parlamentare mbi çështjet e fëmijëve është 5.		Deri në fund të vitit 2020 do të jenë rritur me 30% numri i dëgjësave për çështjet e fëmijëve.
Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve	Numri i stafit për mbrojtjen e fëmijëve i punësuar në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor, sipas standarteve ligjore.	Aktualisht janë 202 NJMF në nivel vendor. Vetëm XX% e tyre janë punonjës sociale. Asnjë bashki nuk ka ngritur strukturat sipas legjislacionit 18/2017.	Deri në fund të vitit 2017 numri i NJMF/PMF do të jetë rritur me 20% ;	Deri në fund të vitit 2020, 100% NJMF sipas parashikimeve në legjislacion; 50% PMF sipas parashikimeve në legjislacion; 100% NJQV do të kenë të paktën 1 GTM, sipas kërkesave ligjore
	% e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve të inspektuara	Monitorimi aktual i shërbimeve nuk kryhet apo raportohet sipas një metodologjie të standardizuar.	Deri në fund të vitit 2017 do të jetë përfunduar dhe miratuar metodologjia për monitorim e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe inspektim e standardeve	Deri në fund të vitit 2020 do të jenë inspektuar dhe monitoruar 100% e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve
	% e NJQV me buxhet për menaxhimin e rasteve	Aktualisht nuk ka buxhetim për menaxhimin e rasteve		Në vitin 2020, 10% e NJQV do të pilotojnë një linjë buxhetore të re për menaxhimin e rasteve

	% e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve që përdorin sistemin	Aktualisht nuk ka një sistem elektronik për menaxhimin e të dhënave të mbrojtjes së fëmijëve	Deri në fund të vitit 2018 do të jete	Deri në fund të vitit 2020 sistemi i menaxhimit të të dhënave është funksional në 50% të Bashkive
	Numri i profesionistëve të fushave të tjera (arsimi, shëndetësia, siguria etj.) të aftësuar që janë të lidhur me mbrojtjen e fëmijëve	Nuk është bërë asnjë vlerësim i nevojave të profesionistëve të fushave të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve		Deri në fund të vitit 2020, 100% e profesionistëve të identifikuar do të jenë aftësuar për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve
	Numri i NJQV që implementojnë programe të prindërimit pozitiv	Aktualisht ofrohen vetëm trajnime për prindërimin nga OJF, të cilat janë sporadike dhe jo të qëndrueshme		Deri në fund të vitit 2020 do të jetë pilotuar modeli në të paktën 5 NJQV .
	% shkollave në të cilat personeli mësimor është aftësuar për reduktimin e dhunës dhe përdorimin e sjelljeve pozitive në shkollë	Të dhënat e studimit bazë për programin COMBI tregojnë se në shkolla ka praktika të dhunshme, fizike dhe psikologjike veçanërisht ndaj djemve	Në fund të vitit 2018 personeli mësimor në 40% të shkollave është aftësuar për reduktimin e dhunës dhe përdorimin e sjelljeve pozitive në shkollë	
	% e institucioneve punonjësit të qendrave rezidenciale të cilët janë trajnuar	Punonjësit e institucioneve rezidenciale marrin njohuritë për pasojat e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve, megjithatë ka patur raste ku është përdorur dhunë	Deri në fund të vitit 2017 do të jenë aftësuar punonjësit e 10% institucioneve mbi legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve, pasojat e dhunës tek fëmijët dhe metodat e disiplinimit pozitiv	Deri në fund të vitit 2020, 100% e institucioneve rezidenciale do të ketë një staf të aftësuar mbi legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve, pasojat e dhunës tek fëmijët dhe metodat e disiplinimit pozitiv.

	Numri i planeve lokale të hartuara për fëmijët në situatë rruge	Plani i Veprimit për Fëmijët në Situatë 2015 - 2017 Rruge po zbatohet në 7 Bashki dhe ka patur rezultate pozitive në shumicën prej tyre. Në raportin e vitit 2015 - 2016 janë menaxhuar 345 raste të fëmijëve në situatë rruge	Plani i Veprimit do të shtrihet edhe në 6 bashki të reja deri në fund të 2017.	
	Numri i fushatave ndërgjegjësuere për prindërit dhe fëmijët per sigurine online te femijeve		Deri në fund të vitit 2017 do të jetë realizuar 1 fushatë ndërgjegjësimi për sigurinë online	Deri në fund të vitit 2020 do të jenë realizuar 3 fushata ndërgjegjësimi për sigurinë online
Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët (Drejtësia)	Paketa informative kros-kurrikulare lidhur me edukimin ligjor te femijeve	Deri tani nuk patur asnjë aktivitet të ngritjes së kapaciteteve në arsim me qëllim ofrimin e njohurive mbi çështje të lidhura me sistemin e drejtësisë për fëmijët	Deri ne fund te vitit 2017 do të jetë pilotuar në 10 shkolla kurrikula e përmirësuar me informacion mbi sistemin e drejtësisë	Deri në fund të vitit 2020, 100% e DAR do të kenë staf të trajnuar si trajnerë mbi çështje të lidhura me sistemin e drejtësisë.
Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët (Mbrojtja Sociale)	Propozime të draftuara mbi ndryshimet ligjore% e rritjes së vlerës së përfitimeve (të kushtëzuara) për fëmijët në skemën e Ndhmës Ekonomike;	Efektiviteti i përfitimeve të kushtëzuara në skemën e ndihmës ekonomike nuk është dokumentuar ende.		Në fund të vitit 2020 vlera e përfitimeve do të rritet minimumi me 50% (përfitimeve të shtuara të kushtëzuara)

	Numri i standardeve të rishikuara/hartuara; % e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë me standarde te rishikuara/ miratuara	Në kuadër të miratimit të ligjit të ri të shërbimeve shoqërore, është evidentuar nevoja e rishikimit të standardeve të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror , dhe hartimi i standardeve të reja, shoqëruar me metodologjinë përkatëse	Ne fund te vitit 2017 - kuadri ligjor i shërbimeve tëpërkujdesit shoqëror që targeton fëmijët brenda paketës së shërbimeve shoqërore është përmirësuar (6 – 8 VKM dhe udhëzime të Ministrit)	Ne fund te vitit 2020 - 100 % e shërbimeve të përkujdesit shoqëror që targetojnë fëmijët janë të mbuluara me standarde të cilësisë të rishikuara/ përmirësuar/reja të miratuara
	Numri i shërbimeve të ngritura në NJQV me fokus fëmijët; % e NJQV që kanë ngritur shërbime të përkujdesit shoqëror me fokus fëmijët në nevojë	Shërbimet e përkujdesit shoqëror për fëmijët që ofrohen në nivel vendor nuk përputhen me spektrin e paketës së shërbimeve ose nuk reflektojnë nevojat për shërbime.		Në fund të vitit 2020, 10% -30 % e NJQV kanë shërbime të përkujdesit shoqëror të ngritura (që targetojnë fëmijët); - numri i fëmijëve në institucione rezidenciale është ulur me 50% (në zonat e targetuara); 50% rritje e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar që marrin shërbime të përkujdesit shoqëror (në zonat e targetuara
	% e rritjes së strukturave të monitorimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	Në kuadër të miratimit të ligjit të ri të shërbimeve shoqërore, është evidentuar nevoja e rishikimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, dhe si rrjedhojë edhe instrumenteve të monitorimit të tyre.	Deri ne fund te vitit 2017 - Strukturat e monitorimit në nivel vendor dhe qendror do të jenë shtuar me 20%	Deri ne fund te vitit 2020-Strukturat e monitorimit në nivel vendor dhe qendror do të jenë shtuar me 50%

	% e rritjes së strukturave të inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror	Kapacitetet aktuale të institucioneve përgjegjëse, duke përfshirë ato në nivel vendor, nuk janë efektive për të inspektuar shërbimet e përkujdesit shoqëror, me fokus tek fëmijët.	Në fund të vitit 2017 stafi i inspektoriatit qendror do të rritet me 50% .	Në fund të vitit 2020 stafi i inspektoriatit qendror do të rritet me 30% - 50 % punonjës të tjerë
	Manuali i trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të NJVNR	Deri tani nuk janë hartuar manuale bazuar në evidenca mbi fuqitë përballuese të familjeve për të adresuar pasojat e varfërisë		Në fund të vitit 2020, në 10% të NJQV kapacitetet e NJVNR – ve për këshillimin e familjeve janë ndërtuar dhe zhvilluar (me qëllim rritjen e fuqive përballuese të familjes për të adresuar pasojat e varfërisë)
	VKM për të përfshirë prindërit e famijeve vulnerable (duke përfshirë prindër me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe prindër me fëmijë në kujdesin alternativ) në grupet që duhet të kenë prioritet në skemat e nxitjes së punësimit dhe në ndërmarrjet sociale	Nuk ka të dhëna për punësimin e prindërve nga skemat e nxitjes së punësimit as nga ndërmarrjet sociale	Në fund të vitit 2017 - 1 - 2 % më shumë prindër punësohen përmes programeve të nxitjes së punësimit	Në fund të vitit 2018 ndërmarrjet sociale kanë 30% të stafit të tyre nga grupi i prindërve brenda skemave me NE dhe 50% e këtij grupi përfaqësojnë prindër me aftësi të kufizuara

Sisteme dhe shërbime shëndetësore miqësore për fëmijët dhe adoleshentët (Shendetesia)	Manuali i përdorimit dhe trajnimit të punonjësve që ofrojnë shërbimin dhe mbledhin të dhënat e sistemit të informacionit shëndetësor të vaksinimit	Sistemi Informativ i Vaksinimit është pilotuar në rajonin Shkodër duke filluar nga 2011, me mbështetjen e OBSH dhe projektit PATH	Deri në vitin 2017 do të përfunduar manuali dhe plani i trajnimit	Deri në vitin 2020, sistemi informativ i vaksinimit do të jetë shtrirë dhe funksional në 4 rajonet shitesë.
	Raporti i studimit mbi marketimin, tregtimin dhe përmbajtjes së produkteve në/ pranë institucione arsimore publike dhe jopublike	Duke qenë se vitet e fundit ofrimi i vakteve dhe marketimi i produkteve në institucionet arsimore është shtuar, ka nevojë që të rishikohen aktet rregulluese mbi marketimin dhe tregtimin e tyre.		100% e drejtorive rajonale të AKU raportojnë mbi situatën dhe masat e propozuara. Përqindja e institucioneve arsimore publike të inspektuara çdo vit që zbatojnë kuadrin rregullator.
	Nr. i punonjësve të trajnuar në të gjithë vendin të përfshirë në mbledhjet dhe raportimin e të dhënave për ushqyerjen e fëmijëve	Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 242, datë 14.06.2016 përcakton 1,080 profesionistë në vend që do trajnohen mbi përdorimin e sistemit elektronik të ngritur	Deri në fund të vitit 2017 janë trajnuar 100% e personelit të ngarkuar për përdorimin e sistemit të të dhënave të ushqyerjes.	
	Plan komunikimi për ndryshim sjellje mbi çështjet e shëndetit riprodhues tek të rinjtë	Nuk ekziston një plan i tillë me fokus të rinjtë.	Deri në fund të vitit 2017 do të jetë hartuar plani i komunikimit për ndryshim sjellje, në konsultim me aktorët në fushë.	Deri në fund të vitit 2020 do të jenë realizuar 30% e aktiviteteve.

Sisteme dhe shërbime shëndetësore miqësore për fëmijët dhe adoleshentët (Zhvillimi dhe Arsimi)	Standardet e zhvillimit, përkujdesjes dhe mirëritjes në kujdesin e hershëm në çerdhe të hartuara dhe të miratuara	Nuk ka ende standarde e as programe të miratuara për zhvillimin në fëmijërinë e hershme	Deri ne fund vitit 2018 pilotohen programet e zhvillimit për fëmijërinë e hershme në 3 NJQV ;	Deri ne fund vitit 2020 zbatimi i standardeve dhe programeve për fëmijërinë e hershme shtrihet në 100% të NJQV
	% e NJQV që ofrojnë programe të prindërimit pozitiv në çerdhe e kopshte	Programet e prindërimitn pozitiv, janë sporadike dhe kryesishte të mbështetura nga OJF		Në fund të vitit 2020 do të jenë realizuar trajnime të profesionistëve në çerdhe dhe kopshte për programet e prindërimit pozitiv në 10% të NJQV
	Numri i NJQV - ve që zbatojnë planin e aktiviteteve për gjithëpërfshirjen (regjistrimi dhe ndjekja) e fëmijëve 5 – 6 vjeç	Aktualisht 85% e fëmijëve të kësaj grupmoshe janë në grupin përgatitor	Në fund të vitit 2018 do të jetë zbatuar plani i aktiviteteve në 3 NJQV	Në fund të vitit 2020 do të jetë zbatuar plani i aktiviteteve në 61 NJQV
	% e NJQV - ve që zbatojnë mekanizmin për gjurmimin dhe integrimin e fëmijëve jashtë sistemit shkollor	Aktualisht ky mekanizëm zbatohet në 1 Bashki	Në fund të vitit 2017 mekanizmi do të shtrihet në 30% të NJQV	Në fund të vitit 2020, mekanizmi do të shtrihet në 90% të NJQV
	% e rasteve të trajtuara të fëmijëve në rrezik për të braktisur shkollën.	Ka nevojë për një mekanizëm institucional për parandalimin e dhe trajtimin e rasteve në rrezik për të braktisur shkollën	Në fund të vitit 2017 do të hartohet dhe miratohet protokollin për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik për të braktisur shkollën.	Në fund të vitit 2020 mekanizmi është funksional, shkollat menaxhojnë 100% të rasteve të identifikuara

	% e personelit mësimor dhe strukturave të tjera të shkollës të trajnuar, lidhur me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës në shkolla	Studime të ndryshme tregojnë që mësuesit kanë nevojë për rifreskimin e njohurive dhe rritjen e aftësive në këto fusha		Në fund të vitit 2020, 100% e mësuesve do të jenë trajnuar.
	Mekanizmat/ instrumentat komunikimi të hartuar/zhvilluar Numri i prindërve të informuar mbi rolin dhe mundësitë e tyre për t'u përfshirë dhe qenë pjesëmarrës në jetën shkollë	Këshilli i prindërve është ngritur si strukturë, por mirëfunksionimi i tij raportohet të jetë problematik. Pritet që MAS të ngrejë mekanizma të raportimit të përfshirjes së prindërve në shkolla.	Në fund të vitit 2017 plani vjetor/plani i i aktiviteteve të shkollësdo miratohet me pjesëmarrjen e Këshillit të prindërve dhe Bordit të shkollës në 10 % të shkollave	Në fund të vitit 2020 plani vjetor/ plani i aktiviteteve të shkollës do miratohet me pjesëmarrjen e Këshillit të prindërve dhe Bordit të shkollës në 30 - 50 % të shkollave
